



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:032745

Datë: 16.05.2024

Numri i dokumentit: 05697431

KPPP.nr. 193/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me gjyqtarin Florent Zeqiri, në çështjen përbarimore të kreditorit Inspektorati i Punës në Mitrovicë – Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, kundër debitorit “Frix” L.L.C., me numër unik identifikues 811339177 dhe me seli në Prishtinë, adresa “Albi Mall”, Zona e Re Industriale, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Agron Krasniqi, avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr. 3049/2023 të datës 20.12.2023, të lejuar nga Përbaruesi Privat Flamur S. Bogaj, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datë 16.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit “Frix” L.L.C., ndërsa Urdhri Përbarimor P.nr. 3049/2023 i datës 20.12.2023, i lejuar nga Përbaruesi Privat Flamur S. Bogaj, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Inspektorati i Punës në Kosovë – Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, në bazë të dokumentit përbarues – Vendimit 01NR.25-89/2023 i datës 06.06.2023 ka caktuar zbatimin e përbarimit përmes urdhrit përbarimor P.nr. 3049/2023 të datës 20.12.2023 ndaj debitorit “Frix” L.L.C., të cilin e ka detyruar që në emër të masës ndëshkimore të shqiptuar sipas aktvendimit të lartcekur, t’ia paguaj kreditorit në afat prej 7 ditësh, shumën e borxhit prej 1,100.00 EUR (njëmijë e njëqind euro), nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm me ndalimin e mjeteve në para të cilat debitori i ka në llogaritë bankare si dhe në shitje të sendeve të luajtshme në pronën e debitorit, si dhe kompensimin e shpenzimeve të procedurës përbarimore.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor ka deklaruar se i kundërshton pretendimet e kreditorit si të paqëndrueshme juridikisht për arsye se ka parashtruar padi për anulimin e Vendimit NR.01.25-89/2023 të Inspektoratit të Punës dhe kundër vendimit të shkallës së dytë me nr. të protokollit 373/2023 të datës 17.08.2023, pasi këto vendime janë të pa baza dhe me shkelje të Procedurës së Përgjithshme Administrative, Ligjit për Konflikt Administrativ, Ligjit të Punës dhe Ligjit të Inspektoratit të Punës. Andaj i ka propozuar Gjykatës që të aprovohet në tërësi i bazuar prapësimi i debitorit, të shfuqizohet urdhri për lejimin e përmbarimit P.nr.3049/2023 i datës 20.12.2023, të shtyhet përmbarimi deri në pranimin e vendimit ndaj padisë për anulim të vendimit të Inspektoratit të Punës, si dhe të obligohet kreditorit që t'i paguajë shpenzimet e procedurës.

Kreditori në përgjigje në prapësim ka theksuar se e kundërshton në tërësi prapësimin e debitorit si të pa bazuar, dhe se propozimi për përmbarim është parashtruar si rezultat i mos pagesës së detyrimeve nga ana e debitorit në mënyrë vullnetare. Po ashtu ka theksuar se Vendimi me NR.01.25.89/2023 i datës 06.06.2023 është i besueshëm, i përmbarueshëm dhe i ekzekutueshëm. Andaj i ka propozuar gjykatës që ta refuzoj prapësimin e debitorit dhe ta lë në fuqi Urdhrin për Përmbarim P.nr. 3049/2023 të datës 20.12.2023 të lejuar nga Përmbaruesi Privat Flamur Bogaj.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbarues ka lejuar përmbarimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përmbarimor, përkatësisht Vendimin Nr.01.25-89/2023 të datës 06.06.2023, në bazë të së cilit përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin dhe gjeti se i njëjti, konform nenit 22 par. 1, nën-par. 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbarues sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla, dhe i cili vendim i përmbarimit të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: *“Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe*

debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”, pasi që në të është treguar kreditori, debitori, objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.

Gjykata tutje vlerëson se Vendimi Nr.01.25-89/2023 i datës 06.06.2023, i plotëson kushtet e përcaktuara edhe në nenin 36 paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmërisë për përmbarueshmëri”*, ngase aktvendimi i lartcekur është i pajisur me klauzolën e përmbarueshmërisë nga e cila rezulton se i njëjti është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm me datë 17.08.2023.

Gjykata i vlerësoi pretendimet e debitorit lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së dokumentit përmbarues, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk janë objekt shqyrtimi i procedurës përmbarimore, prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit objekt përmbarimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21, 22, 24 dhe 27 të LPP-së.

Pretendimet se ndaj vendimit të lartcekur është parashtruar padi në procedurën e konfliktit administrativ gjykata i vlerësoi si të pa ndikim për vendosje ndryshe në këtë çështje përmbarimore ngase ushtrimi i padisë në konflikt administrativ nuk paraqet pengesë për ekzekutimin e vendimit mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri, kjo në kuptim edhe të dispozitës nga neni 22 të Ligjit për Konfliktet Administrative, me të cilin përcaktohet se *“Padia nuk e ndalon ekzekutimin e aktit administrativ kundër të cilit është paraqitur përveç kur kjo me ligj është parashikuar ndryshe”*.

Nga arsyet e paraqitura më lartë, dhe duke u bazuar në nenin 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 193/24, datë 16.05.2024

Gjyqtari
Florent Zeqiri

Numri i lëndës: 2024:032745
Datë: 16.05.2024
Numri i dokumentit: 05697431

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.